

# Aplikantët për Mbrojtje Ndërkombëtare

## Seksioni përmbledhës

Në Bankën e Irlandës, ne krenohemi me përmirësimin e mirëqenies financiare të të gjithë klientëve tanë. Në thelb të mirëqenies financiare është përfshirja financiare dhe kjo do të thotë qasje në produktet themelore bankare për të gjithë. Ne mbështesim aplikantët për mbrojtje ndërkombëtare duke siguruar aksesueshmeri në produktet bankare dhe duke njohur nevojën për shërbime interpretuese për t'u siguruar që ata marrin shërbimin e nevojshëm financiar.

Ne kemi dy produkte për nevoja të përditshme bankare të cilat mund të jenë të përshtatshme për aplikantët për mbrojtje ndërkombëtare; një llogari rrjedhëse personale dhe një llogari bankare kryesore. Të dyjat nga këto produkte ju ofrojnë një vend të sigurt për të mbajtur dhe për të pasur qasje në paratë tuaja. Janë dhënë detajet për secilën nga këto llogari dhe një listë e dokumenteve të kërkuara për të hapur këto llogari.

Kur të keni gati dokumentacionin tuaj të kërkuar, ju mund të vini në çdo degë të Bankës së Irlandës dhe ne mund të fillojmë procesin për të krijuar llogarinë tuaj të re.

Ne e kuptojmë se disa klientë mund të mos e flasin gjuhën angleze ose mund të mendojnë se aftësitë e tyre në anglisht nuk janë të mjaftueshme për të qenë në gjendje t'u përgjigjen pyetjeve gjatë një vizite në degë. Nëse ky rast vlen edhe për ju, atëherë ne jemi të gatshëm që ju të sillni një mik, koleg ose përkthyes me ju që mund të përkthejë për ju.

Përveç kësaj, disa kolegë të Bankës së Irlandës flasin disa gjuhë dhe ne do të ishim të lumtur të ofronim ndihmë nëse nuk keni dikë që mund të interpretojë për ju. Thjesht pyesni Këshilltarin tuaj të mireseardhjes në degë.

Detajet për degët tona mund t'i [gjeni këtu](#)